



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 323, datë 22.07.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NR. 338, DATË 24.09.2020 “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE
PËR DHËNIEN E STATUSIT TË NËPUNËSIT CIVIL GJYQËSOR, PUNONJËSVE NË
DETYRË NË GJYKATA”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 61, 90, pika 1, shkronja “ç” dhe nenin 97 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 84-88 të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 338, datë 24.09.2020, “Për caktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënie të statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në nenin 6 pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1.Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.”

2. Ngarkohen gjykatat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR